

PIDOCCHI ALBANESE

Semundja e morrave

Cfare jane morrat?

Mund te ngaterrohen me zbokthin nderkohe qe morri i lekures se kokes eshte nje parazit qe jeton e riprodhohet vetem ne koken e njeriut.

Ne floke mund te kete MORRA TE RRITUR (jo gjithmone shihen lehtesisht) e THERRIZA (veze qe depozitohen ne rrenjen e flokut, hapen pas 8-10 ditesh e jane shume te vogla).

Si ngjiten?

Morrat mund te zene vend ne cdo person te cdo rangu shoqeror dhe prania e tyre nuk tregon mungese pastertie ose higjiene personale te manget.

Ngjitja eshte shume e lehte nga koka ne koke dhe prandaj kjo semundje eshte e shpeshtene shkolla dhe bashkesi.

Si parandalohen?

Eshte e keshillueshme te kontrollohet koka e femijeve tuaj (te pakten cdo jave) per te kerkuar pranine e vezeve (duke perdorur nje burim drite dhe nje lente zmadhuese).

Ne treg nuk ekzistojne produkte parandaluese.

Per vajzat e vogla me floke te gjata preferohen floket e mbledhur.

Eshte shume e rendesishme te lajmerohet shkolla e cila me pas do te lajmeroje A.S.L. perkates per te parandaluar sa me heret perhapjen e paraziteve.

TRAJTIMI

Ne rastet e verifikuara.

- Te behet trajtimi me produkte specifike e locione sipas udhezimeve
- Te perseritet trajtimi pas 7 10 ditesh
- Te perdoret ne floke nje kreher me dhembe te dendur
- Te kontrollohen anetaret e familjes
- Te lahen teshat personale me uje te zier. Te lahen kreherat.

Morri nuk mbijeton jashte njeriut per me shume se 48 ore dhe aftesia e tij ngjitesore me kalimin e kohes bie prandaj

dezinfektimi i ambientit eshte nje gje dytesore

nderkohe qe eshte shume i rendesishem **TRAJTIMI NE TE NJEJTEN DITE PER TE GJITHE PERSONAT E SEMURE.**